

**REPUBLIKA E SHQIPERISE**  
**MINISTRIA E EKONOMISE PUBLIKE DHE PRIVATIZIMIT**  
**Drejtoria e Privatizimit te S.M.E.**

**U R D H E R**

**Nr.\_99/2 Date, 14.07.1999.**

**PER**

**NDRYSHIME NE AKTET E THEMELIMIT TE S.H.A. "ALBKROM" TIRANE**

Ne baze te paragrafit te pare, te nenit 2 te Ligjit Nr.8237, date 1.09.1997 "Per disa ndryshime ne Ligjin Nr.7926, date 20.04.1995 "Per transformimin e ndermarrijeve ne shoqeri tregtare ndryshuar me dekretin Nr.1195, date 14.08.1995, Ligjin Nr.8099, date 28.08.1996, Dekretin Nr.1631, date 1.11.1996 dhe Ligjin Nr.8158, date 7.11.1996", me cilesine e aksionerit te vetem si dhe V.K.M. Nr.271, date 9.05.1998 "Per miratimin e statutit tip te shoqerive anonime shteterore"

***Urdheroj:***

1. Ndryshimin e statutit te shoqerise anonime "Albkrom" Tirane si me poshte :

1.1. Parografi I trete I nenit 1 formulohet :  
"Selia e shoqerise eshte ne adresen " Blloku Vasil Shanto" Tirane.

1.2 Neni 2 formulohet,  
Objekti I shoqerise eshte :

- Hapja, pergatitja, nxjerra, pasurimi dhe perpunimi I mineralit te kromit me rezultat perfundimtar prodhimi I mineralit te kromit, koncentratit te kromit e ferrokromit.

- Shitja e blerja e mineralit te kromit, koncentratit te kromit, ferrokromit si dhe materialeve, makinerive e paisjeve qe perdoren ne industrine e kromit.

- Shfrytezimi dhe mirembajtja e vendburimeve minerare , makinerive e paisjeve dhe gjithe pasurive te tjera te saj.

- Hapja dhe mbyllja e vendburimeve te reja e atyre ekzistuese per prodhimin e mineralit te kromit e mineraleve te tjera qe i sherbejne teknologjive te aplikuara ne njesite e saja.

- Kryerja e aktiviteve per studimin, projektimin, zbulimin shfrytezimin, permiresimin e teknologjise se nxjerrjes dhe perpunimit te objekteve te shoquerise vete ose ne bashkepunim me te tretet.

- Shoqeria merr persiper ruajtjen e objekteve konform legjislacionit ne fuqi.

Shoqeria brenda kufijeve qe parashikon legjislacioni ne fuqi, mund te kryeje çdo operacion tjeter prodhues, finanziar dhe tregtar i cili lidhet drejtepersedrejti ose terthorazi me objektin e saje. Ajo mund te hape veprimtari te reja mund te krijoje shoqeri te reja si dhe te marre pjese ne kapitalin e shoqerive te tjera si brenda dhe jashte vendit, pa cenuar objektin e shoquerise.

Sh.A."Albkrom" Tirane mund te rrite ose pakesoj numrin e njesive ne vartesi te saj.

### 1.3. Neni 4 formulohet :

Transferimi i aksioneve ne rastin e privatizimit

Transferimi i aksioneve ne rastin e privatizimit do te kryhet me urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit ne baze te legjislacionit ne fuqi per privatizimin.

### 1.4. Neni 5 formulohet :

Organet drejtuese te shoquerise

Organet drejtuese te shoquerise jane:

1. Keshilli mbikqyres
2. Drejtoria

### 1.5. Paragrafi I pare I nenit 6 formulohet :

Keshilli mbikqyres perbehet nga 9 anetare. Anetaret e keshillit mbikqyres emerohen nga Ministri i Ekonomise Publike dhe Privatizimit.

## 1.6. Pragafi I dyte I nenit 6 formulohet :

Kohezgjatja e fuksionimit te tyre eshte 4 (kater) vjet. Anetaret e keshillit mbikqyres jane te gjithe te rizgjedhshem. Ata mund te shkarkohen ne çdo kohe nga Ministri I Ekonomise Publike dhe Privatizimit.

## 1.7. Paragafi I fundit I nenit 6 hiqet .

## 1.8. Ne fund te nenit 7 shtohet nje paragraf me kete permbajtje :

Ne rast mungese ose pengimi te kryetarit mbledhjet e keshillit mbikqyres drejtohen nga Zv.kryetari.

## 1.9. Ne neni 8 fjala "drejtori" zevendesohet me fjalen "drejtoria".

## 1.10. Paragafi 10 I nenit 8 formulohet :

Vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi, nga kryetari ose zv.kryetari.

Kopjet e vendimeve vertetohen nga kryetari ose zv.kryetari I keshillit mbikqyres.

## 1.11. Neni 9 formulohet :

Kopetencat e keshillit mbikqyres

- Keshilli mbikqyres ushtron kontroll te perhershem per administrimin e shoqerise nga drejtoria dhe i jep kesaj te fundit autorizimin per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga drejtoria pa autorizimin e keshillit mbikqyres.
- Keshilli mbikqyres emeron drejtorine kur per te bien dakord jo me pak se 2/3 te tij. Ai cakton njerin prej anetareve te drejtorise me cilesine e drejtorit.
- Me emerimin e anetareve te drejtorise keshilli mbikqyres lidh kontrate me ta per detyrimet qe rrjedhin ne administrimin e shoqerise.
- Keshilli mbikqyres autorizon drejtorine qe te kryeje veprimet dhe te realizoje marreveshjet e parashikuara ne nenet 12 dhe 13 te statutit.
- Keshilli mbikqyres ka te drekte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontolle qe ia i çmon te pershatshme dhe te njihet me dokumentacionin qe i gjykon te nevojshem per permbushjen e detyres se tij.
- Keshilli Mbikqyres te pakten njehere ne tre muaj merr ne rapport drejtorine.

- Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit financier drejtoria duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres illogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli.
- Keshilli mbikqyres mund ti ngarkoje njerit ose disa anetareve te tij çdo mandat te posaçem per një ose disa objekte te caktuara.

II. Keshilli mbikqyres i propozon Ministrin te Ekonomise Publike dhe Privatizimit lidhur me keto çeshtje :

- a) Percaktimin dhe ndryshimin e programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesme dhe afatgjate te shoqerise.
- b) Kryerjen e investimeve dhe financimeve per vitin financier si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e kapitalit themeltar te shoqerise.
- c) Hapjen e veprimtarive dhe njesive te reja dhe ndryshimin e objektit te shoqerise.
- d) Shitjen e pasurive qe perbejne aktivin e qendrueshem te shoqerise.
- e) Krijimin e shoqerive te reja dhe pjesmarjen ne kapitalin e shoqerive te tjera.
- f) Marrjen e huave afatmesme, afatgjata.
- g) Si dhe per çdo çeshtje tjeter qe ne baze te ligjit "Per shoqerite tregtare" eshte kompetence e Asamblese se Pergjitheshme

1.12. Neni 10 formulohet :

Shperblimi I anetareve te keshillit mbikqyres

Shperblimi I anetareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me kriteret e percaktuara me Vendim te Keshillit te Ministrave.

1.13. Neni 11 formulohet :

Drejtoria

- Shoqeria administrohet nga drejtoria. Numri i anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres.
- Drejtoria emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakord jo me pak se 2/3 (dy te tretat) e te gjithe anetareve te ketij keshilli.
- Anetaret e drejtorise jane persona fizike, ne te kundert emerimi i tyre eshte i pavlefshem. Ata mund te zgjidhen per tu emeruar ne shoqeri dhe jashte te punesuarve ne shoqeri. Nese nje anetar i keshillit mbikqyres

emerohet anetar i drejtorise mandati i tij ne keshillin mbikqyres perfundon. Nje person nuk mund te emerohet anetar drejtorie ose drejtor ne me shume se nje shoperi. Anetaret e drejtorise mund te shkarkohen nga keshilli mbikqyres per shkaqe te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur kontrate punesimi me shoquerine, shkarkimi i tij nga funksioni i anetarit te drejtorise nuk eshte shkak per zgjidhjen e kontrates.

- Anetaret e drejtorise emerohen per nje periudhe kohe prej 4 (kater ) vjetesh. Ne rastet e pushimeve dhe mungesave te zgjatura, keshilli mbikqyres ben zevendesimin e tyre.
- Anetaret e drejtorise jane te riemerueshem, ata nuk mund te jene mbi moshen 65 (gjashtedhjete e pese) vjeç. Anetari i drejtorise qe mbush moshen 65 (gjashtedhje e pese) vjeç konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.
- Paga e anetareve te drejtorise caktohet nga keshilli mbikqyres ne aktin e emerimit te tyre.
- Eshte e detyrueshme qe çdo marredhenie ndermjet drjetorise dhe keshillit mbikqyres te pasqyrohet me shkrim.

#### 1.14. Neni 12 formulohet : Kompetencat e drejtorise

- I.Drejtoria ka kompetenca te plota per te vepruar ne emer te shoquerise.
- Ne marredheniet me te tretet shoqeria merr persiper detyrime qe rrjedhin nga aktet e drejtorise te nenshkruara nga anetari me cilesine e drejtorit edhe kur keto e tejkalojne objektin e veprimtarise se shoquerise, perveç rastit kur shoqeria provon se te tretet e dinin qe akti i drejtorise kapercante objektin e veprimtarise se shoquerise dhe vepronte me keqbesim, ose kur te tretet nuk mund te injoronin kete akt, duke pasur parsysh faktin se shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.
- Aktet me te cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve duhet te nenshkruhen nga anetari me cilesine e drejtorit ose personi i autorizuar rregullisht nga ky i fundit per keto akte.
- Drejtoria merr vendim me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem kur jane prezent jo me pak se gjysma e anetareve te saje. Ne rast barazimi votash, vota e anetarit te caktuar me cilesine e drejtorit eshte percaktuese.
- Lidhja e kontratave me afat mbi 2 (dy) vjet dhe me vlere mbi 2 (dy) milion leke behet me autorizim te keshillit mbikqyres.
- Marredheniet brenda shoquerise percaktohen me rregullore qe miratohet nga keshilli mbikqyres.

- Drejtoria ben strukturen e organizimit te shoqerise te cilen e miraton keshilli mbikqyres.
- II. Drejtoria merr vendime dhe miraton programin teknik, ekonomiko-financiar te veprimtarise te gjithe njesive ne varesi te saj.
- Drejtoria ben strukturen e organizimit te shoqerise te cilen e miraton keshilli mbikqyres.
- Harton dhe lidh kontraten e punes me sindikatat ne nivel te pare.
- Drejtoria drejton,organizon dhe kryen ne çdo kohe verifikime,analiza dhe kontolle tematike dhe ekonomiko-financiare ne te gjitha njesite e shoqerise dhe analizon aktet e kontrollit duke nxjerre perjegjesite dhe merr masat perkatese.
- Mardheniet mes drejtorise dhe njesive ndertohen sipas nje rregulloreje te brendeshme qe miratohet nga keshilli mbikqyres.
- Drejtoria lidh kontrate pune me drejtuesit e njesive per te drejtat dhe detyrimet qe rrjedhin nga zbatimi I detyres se tyre.
- Maredheniet midis drejtorise dhe njesive dokumentohen gjithnjë me shkrim.

#### 1.15. Neni 13 formulohet :

Marreveshjet ndermjet shoqerise dhe drejtorise ose te nje anetari te keshillit mbikqyres

Çdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe anetereve te drejtorise ose nje anetari te keshillit mbikqyres, qofte e drejteperdrejte ose jo e drejteperdrejte duhet t'i nenshtrohet autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres.

Percaktimi i mesiperm eshte i vlefshem edhe per marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje shoqerie tjeter, kur nje anetari i keshillit mbikqyres eshte edhe anetar i keshillit mbikqyres te nje shoqerie tjeter, me te cilen propozohet te lidhet mareveshje. Kjo nuk eshte e zbatueshme per mareveshjet qe kane te bejne me veprimtarine rrjedhese te shoqerise qe kryhen ne kushte normale.

Anetari i drejtorise ose i keshillit mbikqyres i interesuar duhet te njoftoje keshillin mbikqyres per nje marreveshje per te cilen zbatohet kerkesat e ketij neni te statutit. Anetari i interesuar i keshillit mbikqyres nuk merr pjese ne votimin per dhenien e autorizimit.

#### 1.16. Neni 16 fjala "drejtori" zevendesohet me fjalen "drejtoria"

**1.17. Neni 17 formulohet :**  
**Rezultati ushtrimit dhe caktimi I fitimeve**

Rezultati i ushtrimit percaktohet si diferenca ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit pasi te jene zbritur humbjet e vitit te meparshem.

Nga fitimet e ushtrimit, te paksuara kur eshte rasti me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5 % (pese perqind) per te krijuar rezerven e domosdoshme.

Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme nuk eshte detyrueshme kur kjo rezerve arrin 1/10 (nje te dhjeten) e kapitalit themeltar. Ajo rifillon per nje arsyeshme, kur rezerva e domosdoshme ka zbritur nen 1/10 (nje te dhjetat) e kapitalit.

Perdorimi i fitimit pas zbritjes se rezerves ligjore behet me urdher te Ministrit te Ekonomise Publike dhe Privatizimit.

**1.18. Neni 19 formulohet :**  
**Asambleja e per gjithshme**

Te gjitha kopetencat e asamblese se per gjithshme te parashikuara ne ligjin Nr.7638, date 19.11.1992 "Per shoqerite tregtare" qe nuk jane shprehur ne kete statut ushtrohen nga Ministri I Ekonomise Publike dhe Privatizimit me cilesine e aksionerit te vetem.

**1.19. Neni 20 formulohet :**

Per çfare nuk eshte shprehur ne kete statut I referohet dispozitave te legjislacionit ne fuqi per shoqerite tregtare.

**2. Ndryshim ne aktet e themelimit te Sh.A. "Albkrom" Tirane .**

**2.1 Objekti I shoqerise eshte :**

- Hapja, pergatitja, nxjerrja, pasurimi dhe perpunimi i mineralit te kromit me rezultat perfundimtar prodhimi I mineralit te kromit, koncentratit te kromit e ferrokromit.

- Shitia e blerja e mineralit te kromit, koncentratit te kromit, ferrokromit si dhe materialeve, makinerive e paisjeve qe perdoren ne industrine e kromit.

- Shfrytezimi dhe mirembajtja e vendburimeve minerare , makinerive e paisjeve dhe gjithe pasurive te tjera te saj.

- Hapja dhe mbyllja e vendburimeve te reja e atyre ekzistuese per prodhimin e mineralit te kromit e mineraleve te tjera qe i sherbejne teknologjive te aplikuara ne njesite e saja.

- Kryerja e aktiviteve per studimin, projketimin, zbulim shfrytezimin, permiresimin e teknologjise se nxjerrjes dhe perpunimit te objekteve te shoqerise vete ose ne bashkepunim me te tretet.

- Shoqeria merr persiper ruajtjen e objekteve konform legjisacionit ne fuqi.


Shoqeria brenda kufijeve qe parashikon legjisacioni ne fuqi, mund te kryeje cdo operacion tjeter prodhues, finanziar dhe tregtar i cili lidhet drejtepersedrejti ose terthorazi me objektin e saje. Ajo mund te hape veprimitari te reja mund te krijoje shoqeri te reja si dhe te marre pjese ne kapitalin e shoqerive te tjera si brenda dhe jashte vendit, pa cenuar objektin e shoqerise.

Sh.A."Albkrom" Tirane mund te rrite ose pakesoj numrin e njesive ne vartesi te saj.

## 2.2. Pika 3 e aktit te themelimit formulohet :

Selia e shoqerise eshte ne adresen : "Blloku Vasil Shanto" Tirane.

3. Ngarkohet Drejtoria Privatizimit te Ndermarrjeve dhe Shoqerive te Vogla e te Mesme dhe Drejtoria Juridike te kryeje ne gjykate procedurat e depozitimit te ndryshimeve ne aktet e themelimit te shoqerise .




# AKT - THEMELIMI

## I SHOQERISE ANONIME

Ne Tirane, sot me date 18.01.1996, Ministria e Financave, ne baze te Ligjit Nr.7926, date 20.4.1995, vendosi :

1. Te krijoj shoqerine anonime "Albkromi" Tirane.
2. Objekti i veprimtarise se shoqerise do te jete, nxjerrie, pasurim dhe perpunim mineral kromi, me rezultat perfundimtar prodhim mineral kromi, krom i pasruar dhe ferrokrom, si dhe eksport i tyre.
3. Shoqeria do te kete seline e saj ne qytetin e Tiranes.
4. Kapitali themeltar i shoqerise eshte 5.553.257.000 leke, i ndare ne 5.553.257 aksione, me vlore nominale 1.000 leke.
5. Shoqeria ka nje kohezgjatje te veprimtarise se saj pa afat te caktuar.
6. Keshilli i pare mbikqyres perbehet nga :
  1. Ylli Panariti
  2. Albert Brojka
  3. Alfred Mero
  4. Ilir Shemili
  5. Edmond Bejleri
  6. Pjereta Sata
  7. Gole Vasha
  8. Indrit Selba
  9. Genc Çifliku
7. Ndertimi organizimi dhe funksionimi i shoqerise rregullohet sipas dispozitave te legjislacionit shqiptar si dhe ne baze te statutit dhe ketij akti themelimi.
8. Shoqeria fillon veprimtarine me nenshkrimin dhe miratimin e dokumentave te saj themelues.

DREJTORI I DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE

  
BERZH PIRANIAN

# **STATUT**

## **SHOQERISE ANONIME**

Ne baze te dispozitave te ligjit Nr.7926, date 20.4.1995 "Per transformimin e ndermarrjeve shteterore ne shoqeri tregtar", me autorizim te Ministrit te Financave Z.Berzh Piranian, Drejtor i Drejtoria te Shoqerive Publike nenshkruan statutin e shoqerise anonime si me poshte :

### **Neni 1**

Shoqeria anonyme formohet nga transformimi i ish-ndermarrjes shteterore "Bashkesia Ekonomike Shtetrore e Kromeve "Albkromi" Tirane".

Shoqeria e krijuar ne kete menyre emerohet Sh.A."Albkromi" Tirane.

Selia e shoqerise eshte ne qytetin e Tiranes.

### **Neni 2**

Objekti i shoqerise eshte ; nxjerrje , pasurim, dhe perpunim mineral kromi me rezultat perfundimtar prodhim mineral kromi, krom i pasuruar dhe ferrokrom, si dhe eksporti i tyre.

Shoqeria, brenda caqeve te parashikuara nga legjislacioni ne fuqi, do te kryeje çdo operacion tregtar dhe finanziar qe lidhet drejtoperdrejte ose terethore me objektin e saj. Kjo perfshin gjithashtu hapjen e veprimitarive te reja, krijimin e sipermarrjeve te tjera dhe pjesmarrjen ne sipermarrje te tjera si brenda shtu dhe jashte vendit pa cenuar objektin e shoqerise.

### **Neni 3**

## **KAPITALI THEMELTAR-AKSIONET**

Kapitali themeltar i shoqerise eshte 5.553.257.000 leke. Ai eshte i ndare ne 5.553.257 aksione te se njejtes kategori, te cilat zoterohen teresisht nga shteti.

Vlera nominale e aksionit eshte 1.000 leke.

Ne shumen e kapitalit te shoqerise nuk eshte perfshire vlera e truallit, gje qe do te behet ne nje kohe te dyte perpara se shoqeria te privatizohet ose ne momentin e privatizimit.

### Neni 4

#### **SHITJA E AKSIONEVE NE RASTIN E PRIVATIZIMIT**

Aksionet e shoqerise mund t'u shiten personave fizike e juridike shqiptare vetem ne rastin e nje vendimi te marre nga Ministri i Financave per privatizimin e shoqerise nepermjet bonove te privatizimit dhe/ose lekeve te privatizimit

Personat e huaj, fizike e juridike, mund te blejne aksione te shoqerise vetem ne rastet dhe ne masen e caktuar nga Ministri i Financave. Shlyerja e aksioneve nga personat e huaj, fizike e juridike, behet vetem me para ose me anen e kontributeve ne natyre per qellime teknologjike.

Ky nen nuk zbatohet per shoqerite qe veprojnene sektoret e naftes, minierave dhe energjise elektrike, aksionet e te cilave shiten sipas legjislativit perkates te privatizimit te seciles prej tyre.

### Neni 5

#### **ORGANET DREJTUESE**

Organet drejtuese te shoqerise jane :

1. Keshilli mbikqyres
2. Drejtori i pergjithshem

### Neni 6

#### **KESHILLI MBIKQYRES**


1. Keshilli mbikqyres perbehet 9 anetare.  
Anetaret e keshillit mbikqyres emerohen :

1/3 nga Ministri i Financave

2/3 nga Ministri i Burimeve Minerare dhe Energjite.

II. Kohezgjatja e fuksionit te tyre eshte 4 vjet. Anetaret e keshillit mbikqyres jane te gjithe te rizgjedhshem. Ata mund te revokohen nga titullari i organit qe i ka emeruar vetem per shkaqe te perligjura.

III. Anetaret e keshillit mbikqyres jane persona fizike. Aka nuk mund te jene te punesuar ne shoqeri.



IV. Ne se nje ose disa vende te anetareve te keshillit te mbikqyres mbeten bosh per shkak vdekjeje, shkarkimi ose doreheqje, zevendesimi duhet te kryhet jo me vone se tre muaj.

Anetari i keshillit mbikqyres, i emeruar me zevendesim te nje anetari tjeter, perfundon mandatin e paraardhesit.

V. Anetaret e keshillit mbikqyres nuk mund te bejne pjesë ne me shume se tre keshilla mbikqyres te shoqerive anonime qe e kane seline ne territorin e Republikes se Shqiperise.

VI. Anetaret e keshillit mbikqyres te moshes mbi 65 vjeç nuk mund te jene me shume se nje e treta e numrit te per gjithshem ne mbyllje te ushtrimit te çdo viti financiar. Nese kjo per qindje tejkalo het anetari me i moshuar do te konsiderohet i shkarkuar zyrtarisht.

VII. Ky keshill do te fuksionoje deri ne momentin e shitjes se aksioneve. Pastaj shoqeria do fuksionoje ne perputhje me legjisacionin ne fuqi.

### Neni 7

## KRYETARI DHE ZEVENDESKRYETARI I KESHILLIT MBIKQYRES

Keshilli mbikqyres zgjedh ndermjet anetareve te tij nje kryetar dhe nje zevendeskryetar te cilet ngarkohen te mbledhin keshillin dhe te drejtojne diskutimet. Ata emerohen per te gjithe kohen e mandatit te tyre ne keshillin mbikqyres dhe jane te rizgjedhshem.

Keshilli mbikqyres mund te emeroje nje sekretar jashte anetareve te tij.

### Neni 8

## VENDIMET E KESHILLIT

Keshilli mbikqyres mblidhet sa here qe e kerkon interes i shoqerise, me thirrjen e kryetarit, ose ne mungese te tij, te zevendeskryetarit.

Kryetari duhet te therrase keshillin mbikqyres, brenda pesembetdhjete diteve, kur drejtori ose nje e treta e anetareve te keshillit mbikqyres i paraqitin atij nje kerkesa te motivuar per kete qellim.

Nese kerkesa mbetet pa pergjigje, atehere autoret e saj mund te therrasin keshillin, duke i permendor rendin e dites.

Ne parim thirrja duhet te behet tre dite perpara, me leter, telegram, teleks ose telefaks. Por ajo mund te behet me goje dhe pa afat ne qofte se anetaret e keshillit mbikqyres e pranojne ate.

Qdo thirrje duhet te treguje çeshtjet kryesore te rendit te dites.

Mbledhja e keshillit mbikqyres behet ne seline e shoqerise ose ne çdo vend tjeter te treguar ne thirrje.

**II.** Keshilli mbikqyres mund te marre nje vendim te vlefshem, ne qofte se jane te pranishme jo me pak se gjysma e anetareve te keshillit.

Vendimet merren me shumice te thjeshte votash te anetareve te pranishem. Ne rast votash te barabarta, ajo e kryetarit eshte percaktuese.

**III.** Keshilli mbikqyres mban nje register te pjesmarrjes ne mbledhjen e tij, i cili nenshkuhet nga anetaret e pranishem ne mbledhje.

**IV.** Vendimet e keshillit mbikqyres evidentohen me procesverbale te hartuara ne pajtim me dispozitat ligjore ne fuqi, nga kryetari i seances dhe nga nje anetar i keshillit ose, ne mungese te kryetarit, nga jo me pak se dy anetare te keshillit.

Kopjet e ketyre procesverbaleve vertetohen nga kryetari keshillit mbikqyres, zevendeskryetari dhe nga drejtori i pergjithshem.

### Neni 9

## **KOMPETENCAT E KESHILLIT MBIKQYRES**

Keshilli mbikqyres ushton kontroll te perhershem per administrimin e shoqerise nga drejtori i pergjithshem i saj dhe i jep ketij te fundit autorizimin paraprak per kryerjen e operacioneve qe nuk mund te kryhen nga drejtori i pergjithshem pa autorizimin paraprak te keshillit mbikqyres.

Keshilli mbikqyres emeron drejtorin e pergjithshem.

Ai autorizon marreveshjet e parashikuara ne nenin 13 te ketij statuti.

Ai autorizon drejtorin e pergjithshem te kryeje veprimet qe te marre masat e parashikuara ne nenin 12 te jetij statuti.

Keshilli mbikqyres ka te drejte te kryeje ne çdo kohe verifikime dhe kontolle qe ai i çmon te pershtatshme, dhe kerkon te njihet me dokumentet qe ai i gjykon te nevojshme per permbushjen e dyteres se tij.

Drejtori i paraqet raport keshillit mbikqyres te pakten nje here ne tre muaj.

Brenda tre muajve nga data e mbylljes se ushtrimit finanziar, drejtori duhet t'i paraqese keshillit mbikqyres llogarite vjetore me qellim verifikimi dhe kontrolli tyre nga ky i fundit.

Keshilli mbikqyres shqyrton llogarite vjetore dhe reportin vjetor te paraqitur nga drejtori i pergjithshem dhe i paraqit per kete raport Drejtorise te Shoqerive Publike.

Keshilli mbikqyres mund t'i ngarkoje njerit ose disa anetareve te tij çdo mandat te posaçem per nje ose disa objekte te caktuara.

#### Neni 10

### **SHPERBLIMI I ANETAREVE TE KESHILLIT MBIKQYRES**

Shperblimi i anetareve te keshillit mbikqyres do te behet ne perputhje me Vendimin e Keshillit te Ministrave Nr.348 date 3.7.1995 "Per keshillat mbikqyres te shoqerive shteterore".

Masa e shperblimit caktohet nga aksionmbajtesi i vetem.

#### Neni 11

### **DREJTORI I PERGJITHSHEM**

1. Drejtori i pergjithshem emerohet nga keshilli mbikqyres kur per te jane dakord jo me pas se 3/4 e anetareve te ketij keshilli. Ai mund te zgjidhet qofte ndermjet personave te shoqerise, qofte edhe jashte te punesarve te saj.

Nese nje anetar i keshillit mbikqyres emerohet drejtor mandati i tij ne keshill merr fund me hyrjen e tij ne funksion.

Nje person nuk mund te emerohet drejtor ne me shume se nje shoqeri.

Drejtori mund te shkarkohet nga keshilli mbikqyres vetem per shkake te perligjura. Ne rastin kur i interesuari ka lidhur nje kontrate punesimi me shoqerine, shkarkimi i tij nga funksioni i drejtorit nuk eshte shkak per zgjidhjen e kesaj kontrate.

II. Drejtori emerohet per nje periudhe kohe prej 4 vjetesh. Ne rastet te pushimeve dhe te mungesave te tjera te zgjatura, keshilli mbikqyres ben menjehere zevendesimin e tij.

Drejtori eshte i riemerueshem. Ai nuk mund te jete ne moshen mbi 65 vjeç.

Drejtori qe mbush 65, quhet zyrtarisht i shkarkuar dhe zevendesohet menjehre.

Menyra dhe masa e shperblimit te drejtorit caktohen nga keshilli mbikqyres ne aktin e emerimit te tij.

## Neni 12

### KOMPETENCAT E DREJTORIT

I. Drejtori ka kompetenca te plota ndaj te treteve per te vepruar ne emer te shoqerise ne çfardo rrethane, me perjashtim te kompetencave qe i jane caktuar shprehimisht keshillit mbikqyres nga ligji dhe nga ky statut.

Ne marredhenie me te tretet shoqeria merr persiper detyrimet qe rrjedhin nga aktet e drejtorit edhe kur keto akte nuk perfshihen ne objektin e shoqerise, perveç rastit kur shoqeria provon se te tretet e dinin qe akti i drejtorit kapercente objektin e shoqerise dhe vepron te me keqbesim, ose kur te tretet nuk mund ta injoronin kete akt, duke pasur parasysh faktin se vete shpallja e statutit nuk eshte prove e mjaftueshme.

Kufizimet e kompetencave te drejtorit te caktuara ne statut duhet te respektohen nga te tretet.

Megjithate, ne cilesine e masave te rregullimeve te brendhshme te shoqerise, por qe nuk u kundervihet te treteve, veprimet dhe masat e meposhtme kryhen vetem me autorizim te keshillit mbikqyres.

- percaktimi dhe ndryshimi i programit te veprimtarise afatshkurter, afatmesme dhe afatgjate te shoqerise.

- kryerja e investimeve dhe financimeve per vitin finanziar si dhe masat e tjera qe do te kerkonin ndryshimin e buxhetit fillestar te shoqerise.

- hapja e veprimtarive ose e njesive te reja, shkrirja ose bashkimi dhe mbyllja teresisht e pjeserisht e veprimtarive dhe njesive te shoqerise.

- blerja, shkembimi dhe shitja e pasurive qe perbejne aktivin e gendrueshem te shoqerise.

- themelimi i shoqerive ose pjesmarrja ne shoqeri te tjera te krijuara, ose per t'u krijuar.

- marrja e huave afatmesme, afatgjata, dhenia e dorezanive ose e garancive te tjera kur keto te fundit tejkalojne veprimtarite e zakonshme te shoqerise.

- negocimi, perfundimi a ndryshimi i çdo kontrate me afat mbi 3 vjet ose per nje shume detyrimesh vjetore mbi dy milione leke ;

- percaktimi i kritereve per diskutimin, perfundimin dhe ndryshimin e kontrates se punesimit me punonjesit;

- ne pergjithesi marrja e vendimeve dhe masave qe e kapercejne veprimtarine e zakonshme te shoqerise dhe qe jane te tilla qe mund te sjellin ndryshime ne objektin e shoqerise.

**II. Drejtori i pergjithshem mund te delegoje nje pjese te kompetencave te tij, qe ai i gjykon te dobishme tek nje ose disa persona te tjera qe kryejne fuksione teknike ne drjtimin e shoqerise.**

**III. Drejtori i pergjithshem perfaqeson shoqerine ne marredhenie me te tretet.**

Emertimi dhe pushimi i tij duhet te publikohet ne perputhje me dispozitat ligjore ne fuqi.

Aktet, me te cilat shoqeria merr persiper detyrimet ndaj te treteve, duhet te mbajne nenshkrimin e drejtorit te pergjithshem, ose te personit te autorizuar rregullisht nga drejtori per keto akte.

Eshte e detyrueshme qe çdo mardhenie ndermjet drejtorit te pergjithshem dhe keshillit mbikqyres te regjistrohet ose te pasqyrohet ne procesverbal.

Maredheniet, brenda shoqerive percaktohen me rregullore te veçante te cilat miratohen ne keshillat mbikqyres te ketyre shoqerive.

### Neni 13

#### **MARREVESHJET NDERMJET SHOQERISE DHE DREJTORIT OSE NJE ANETARI TE KESHILLIT MBIKQYRES**

Cdo marreveshje ndermjet shoqerise dhe drejtorit te pergjithshem ose nje anetari te keshillit mbikqyres, qofte e drejtoperdrejte ose jone e drejtoperdrejte, duhet t'i nenshtrohet autorizimit paraprak te keshillit mbikqyres.

Kjo dispozite eshte e zbatueshme edhe per marreveshjet ndermjet shoqerise dhe nje shoqerie tjeter, kur nj anetar i keshillit mbikqyres eshte edhe anetar i keshillit mbikqyres te shoqerise tjeter, me te cilen propozohet te lidhet marreveshja.



Dispozitat e mesiperme nuk jane te zbatueshme per marreveshjet qe kane te bejne me veprimet rrjedhese te shoqerise qe kryhen ne kushtet normale.

Drejtori ose anetari mbikqyres i interesuar duhet te njoftojte keshillin mbikqyres sa po merr dijeni per nje marreveshje, per te cilen zbatohen kerkesat e ketij nenit te satutit. Anetari i keshillit mbikqyres i intersuar nuk merr pjesen e votimin per dhenien e autorizimit.

#### Neni 14

### **EKSPERTI KONTABEL I AUTORIZUAR**

Kontrolli ushtrohet nga nje ose dy eksperete te autorizuar, te cilet emerohen nga aksionmbajtesi i vetem dhe qe kryejne misionin e tyre ne pajtim me ligjin.

#### Neni 15

### **USHTRIMI FINANCIAR**

Ushtrimi finanziar fillon me 1 janar dhe mbaron me 31 dhjetor te çdo viti.

Perjashtimisht ushtrimi i pare finanziar perfshin kohen nga data e regjistrimit ne regjistrin tregtar gjer me 31 dhjetor.

#### Neni 16

### **INVENTARI-LLOGARITE VJETORE**

Shoqeria do te mbaje nje kontabilitet te rregullt te pasurise dhe te veprimtarise se saj, ne pajtim me kerkesat ligjore.

Ne mbyllje te ushtrimit, drejtori harton inventarin e pasurise ne kete date dhe llogarite vjetore per ushtrimin finanziar.

Drejtori pergatit gjithshtu edhe raportin e administrimit per gjendjen e shoqerise gjate ushtrimit finanziar te kaluar, ndryshimet e parashikuara per te ardhmen, ngjarjet me te rendesishme qe kane ndodhur gjate periudhes nga data e mbylljes te ushtrimit finanziar deri ne daten e hartimit te ketij rapporti, si dhe veprimtarite e shoqerise ne fushen kerkimore-shkencore.

## Neni 17 REZULTATI I USHTRIMIT DHE CAKTIMI I FITIMEVE

Rezultati i ushtrimit percaktohet si diferenca ndermjet te ardhurave dhe shpenzimeve te ushtrimit, duke perfshire te keto te fundit amortizimet dhe provisionet.

Nga fitimet e ushtrimit te pakesuara, kur eshte rasti, me humbjet e meparshme, hiqet te pakten 5 perqind per te krijuar rezerven e domosdoshme.

Heqja nga fitimet per rezerven e domosdoshme pushon se geni e detyrueshme kur kjo rezerve arrin nje te dhjeten e kapitalit themeltar. Ajo rifillon kur per nje arsye çfarzo, rezerva e domosdoshme ka zbritur nen nje te dhjeten e kapitalit.

Nga fitimet e ushtrimit te pakesuar, kur eshte rasti, me humbjet e meparshme, shoheria do te heqe jo me shume se 85 perqind per krijimin e rezervave per zhvillim.

Shuma e fitimeve te mbetura pas heqjes per krijimin e rezervave te permendura me siper perfaqeson dividentin, i cili derdh ne buxhetin e shtetit.

Duke perjashtuar rastin kur eshte vendosur zgjedhimi i kapitalit, nga fitimet e ushtrimit nuk behet asnjë heqje dhe asnjë derdhje dividenti, ne qofte se kapitalet e veta jane ose do te beheshin me te vogla se shuma e kapitalit themeltar plus shumen minimale te kerkuar per rezerven e domosdoshme.

Ne qofte se ekziston nje humbje, kjo mbartet per t'u perfshire ne fitimet e ushtrimit te ardhshme deri ne shuarjen e saj.

Caktimi (shperndarja) e fitimeve dhe menyra e mbulimit te humbjeve behen me vendim te ministrit te financave dhe cilesine e tij si aksionmbajtes i vetem ne shoqeri.

## Neni 18 EMERIMI I ANETAREVE TE PARE TE KESHILLIT MBIKQYRES

Si anetare te pare te keshillit mbikqyres emerohen :

- Z. Ylli Panariti banues ne Tirane
- Z. Albert Brojka banues ne Tirane
- Z. Alfred Mero banues ne Tirane
- Z. Ilir Shimilli banues ne Tirane
- Z. Edmond Bejleri banues ne Tirane
- Z. Piereta Sata banues ne Tirane
- Z. Gole Vasha banuese ne Tirane
- Z. Indrit Selba banues ne Tirane
- Z. Genc Çifliku banues ne Tirane



Neni 19

Te gjitha atributet e asamblese se per gjithshme te parashikuara nga ligji Nr.7638 date 19.11.1992 qe nuk jane shprehur ne kete statut do te ushtrohen nga ministri i financave me cilesine e aksionmbajtesimit te shtetit ne shoqeri.

Neni 20

**EMERIMI DHE SHKARKIMI I DREJTORIT TE PARE**

Ne nje afat prej 6 muajsh nga data e regjistrimit te shoqerise drejtori i ish ndermarrjes shteterore do te jete i emeruar zyrtarisht Drejtor i Pergjithshem i Shoqerise dhe do te jete per gjegjes per ruajtjen e pasurise te saj.

Gjate ketij afati ai mund te shkarkohet vetem nga Ministri i Financave dhe per shkage te perligjura mbi bazen e propozimeve te Drejtorise te Shoqerive Publike ose te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise.

Hartuar ne .....1996 me 6 kopje te njejta.

**D R E J T O R I**

I

**DREJTORISE SE SHOQERIVE PUBLIKE**

**BERZH PIRANIAN**